



Kaleidoskopi për Fëmijë

Edicion i veçantë
NCM

SHËRBESA E DHEMBSHURISË NAZARETASE



BASHKËBISEDA QENDRORE

Çfarë do të thotë fjala “Dhembshuri”? Dhembshuria është të kuptuarit e dhimbjes së dikujt dhe ta ndihmosh atë të ndihet i dashur dhe i mbështetur.

Shërbesat e Dhembshurisë Nazaretase ekzistojnë për të ndarë dashurinë e Zotit përmes akteve të dhembshurisë.

Si e tregojnë NCM-ja dhe kishat në mbarë botën dhembshurinë e Perëndisë në veprim?

LOGO E SHËRBESËS SË DHEMBSHURISË NAZARETASE



Duke ndjekur shembullin e Jezusit, Shërbesat e Dhembshurisë Nazaretase (NCM) bashkëpunon me kongregacionet lokale Nazaretase në të gjithë botën për të veshur, strehuar, ushqyer, shëruar, edukuar dhe jetuar në mënyra të lidhura me ata që vuajnë nën shtypje, padrejtësi, dhunë, varfëri, uri dhe sëmundje. NCM-ja ekziston në dhe nëpërmjet Kishës së Nazaretasit për t'ua shpallur Ungjillin të gjithë njerëzve me fjalë dhe vepra.

DHEMBSHURIA NË VEPRIM

Shërbesat e Dhembshurisë Nazaretase punon së bashku me kishat në mbarë botën për të ndihmuar njerëzit të shohin dashurinë e Jezusit në veprim. Më poshtë, do të shihni katër foto me ikona. Secila prej tyre përfaqëson një mënyrë se si jeta dhe komunitetet po transformohen. Shikoni fotot me ikona dhe përpikuni t'i përputhni ato me titullin dhe përshkrimin e tyre.



Zhvillimi Holistik i Fëmijëve – synon të ndihmojë fëmijët të rriten shpirtërisht, fizikisht, intelektualisht, emocionalisht dhe në aspektin relacional.

Gratë dhe Vajzat – mbështet gratë dhe familjet e tyre përmes krijimit të bizneseve të vogla, bujqësisë në shkallë të vogël, edukimit për shkrim–lexim dhe më shumë, në mënyrë që ato të dinë se janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Zotit.

Ujë i Pastër – u siguron komuniteteve ujë të sigurt përmes një programi WASH që përfshin furnizimin me ujë, kanalizimet dhe promovimin e higjienës.

Mbështetje për Refugjatët dhe Imigrantët – mbështetje përmes edukimit për fëmijët, ndihmë emergjente për familjet në krizë, mbështetje për familjet që janë zhvendosur dhe më shumë.


FAQJA E KALEIDOSKOPIT

Shërbesat e Dhembshurisë Nazaretase dhe Misionet Ndërkombëtare Nazaretase janë dy shërbesa të ndryshme në Kishën e Nazaretasit. Secila prej tyre ka një rol të rëndësishëm në kishë.

Shërbesat e Dhembshurisë Nazaretase (NCM) bashkëpunojnë me kishat lokale Nazaretase në të gjithë botën për t'u kujdesur për njerëzit me dashurinë e Krishtit. Misionet Ndërkombëtare Nazaretase (MNN) është në çdo kishë lokale duke ndarë informacion rreth misionit të Zotit në të gjithë botën dhe se si njerëzit mund të përfshihen në atë mision.

Shumë herë MNN –ja ndan informacion rreth asaj që po bën NCM dhe ku ka nevoja në të gjithë botën. Kjo i inkurajon kishat lokale të bashkohen në atë mision të kujdesit për njerëzit si një mënyrë për të treguar se sa shumë i do Jezusi ata. Është një mënyrë e shkëlqyer për të punuar së bashku.

Ndërsa ngjyrosni Kaleidoskopin, do të shihni logon e NCM-së në njërën anë dhe logon e MNN-së në anën tjetër; ato bashkohen nga zemra dhe kryqi në qendër. Do të vini re gjithashtu disa ikona të ndryshme. Shumë prej tyre i keni parë në Kaleidoskopët e tjerë për Fëmijë ose në faqen e mëparshme. Ndërsa ngjyrosni ikonat, vizatoni një vijë drejt shërbesës me të cilën lidhet. Mbani mend, rolet tona janë të ndryshme, por qëllimi ynë është i njëjtë: t'i drejtojmë njerëzit te Jezusi!




"Në të vërtetë po ju them: sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma bëtë mua." Mateu 25:40

AKTIVITETI I KALEIDOSKOPIT PËR FËMIJË

Faqja e dhembshurisë për ngjyrosje

Kjo faqe për ngjyrosje vjen nga një burim i NCM-së që u krijua për Asamblenë e Përgjithshme dhe Konferencën e të Rinjve Nazaretas si një mënyrë argëtuese për të ndarë atë që bën NCM-ja në mbarë botën.

Shijoni ngjyrosjen e kësaj faqeje. Shikoni nëse mund të mbani mend se çfarë përfaqësojnë ikonat ndërsa i ngjyrosni!



NË VEPRIM

Tani është koha për të vënë në praktikë atë që keni mësuar.

Shikoni faqen e internetit të NCM-së: <https://ncm.org>

Faqja e mediave sociale të Shërbesës së Dhembshurisë Nazaretase do të tregojnë mënyra se si kisha juaj lokale mund të bashkëpunojë me NCM-në në kujdesin për njerëzit me dashurinë e Krishtit.

Do të na pëlqente të shihnim dhe të dëgjonim se çfarë po bëni në kishën tuaj lokale për të bashkëpunuar me NCM-në dhe MNN-në. Kërkojuni prindërve tuaj të lidhen dhe të ndajnë në faqet e mediave sociale të MNN-së!



MISIONET NDËRKOMBËTARE
NAZARETASE



MNN-JA GLOBALE